



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM

Nr. 243, datë 09.06.2021

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**RAPORT
I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
TË GJYQTARIT**

Tiranë, më 09.06.2021

Ekstrakt

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE
PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI.**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekte, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, gjyqtari përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra gjatë shqyrtimit në shkallë të parë, por edhe provave të shqyrtuara në gjykimin në apel, referuar faktit të përsëritjes pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor.¹ Në disa raste gjyqtari përshkruan rrethanat procedurale, si dhe faktet e çështjes në përputhje me provat e administruara dhe duke referuar për lehtësi verifikimi edhe faqen përkatëse të dosjes në të cilën ndodhet kjo provë.

Duke u nisur nga mënyra se si janë paraqitur rrethanat e çështjes në 8 vendimet e analizuara, faktet parashtrihen gjithmonë në pjesën e parë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit. Edhe pse në vendime nuk rezulton një nënpjesë e titulluar “Rrethanat e faktit”, referuar mënyrës së përshkrimit të rrethanave të çështjes në përputhje dhe në mënyrë të integruar me provat e administruara, faktet evidentohen lehtësisht.

¹Vendimi nr.36, datë 25.04.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në rastet kur shkaqet e ankimit nuk i referohen përcaktimit të gabuar të rrethanave të faktit, për përcaktimin e këtij të fundit, gjyqtari nuk ripërsërit dhe as liston provat e marra në gjykimin në shkallë të parë. Ai i përmbahet dhe evidenton faktet e provuara në gjykimin në shkallë të parë.

Në çdo vendim gjyqësor evidentohet kujdesi i duhur që gjyqtari tregon për cilësimin e saktë të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike, pavarësisht nëse përcaktimi i gabuar ose jo i faktit, ka përbërë ose jo shkak ankimi.

Pas përshkrimit të fakteve të çështjes, në vendimet e analizuara të cilat kanë zgjidhur në themel mosmarrëveshjen dhe përbëjnë çështje me palë kundërshtare, në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, elementë të faktit të provuar bëhen pjesë e arsyetimit të gjyqtarit mbi bazueshmërinë ose jo të kërkesëpadisë ose të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, përgjithësisht, në vendimet e analizuara gjyqtari përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi në pjesën hyrëse të vendimit, duke identifikuar natyrën e çështjes. Në tre nga vendimet e analizuara, natyra e çështjes nuk përcaktohet në mënyrë eksplicite, por ajo kuptohet referuar analizës juridike që i bëhet marrëdhënies juridike.²

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet e vëzhguara rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm. Kështu, ai ka evidentuar dhe herë pas here cituar, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të Kodit të Procedurës Penale, të Kodit Civil, të Kodit të Punës, të Kodit të Familjes, si dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete.

Sa i përket ligjit procedural, gjyqtari ka referuar dhe cituar në disa raste, si pjesë e arsyetimit të vendimit: nenin 510/d të K.Pr.Civile në lidhje me përcaktimin nëse kontrata e huasë përbën apo jo titull ekzekutiv (vendimi nr. 11, datë vendimi 15.01.2019); nenin 610 të K.Pr.Civile në lidhje me të drejtën e paditësit (*debitor*) për të kundërshtuar veprimet e përmbaruesit gjyqësor, në rast se ato janë në kundërshtim me dispozitat procedurale të kryera nga përmbaruesi gjatë fazës së ekzekutimit, por edhe në lidhje me afatin ligjor brenda të cilit duhet kundërshtuar veprimi përmbarimor; nenin 557 të K.Pr.Civile në lidhje me procedurën e realizimit të ankandit, vlerën e sendit të nxjerrë në ankand, afatin e realizimit të anakandit etj; nenet 559 dhe 572 të K.Pr.Civile në lidhje me pronësinë e fituar nga të tretët pas realizimit të shitjes së sendit në ankand dhe të drejtës së ankimit kundër shitjes apo kundërshtimit të vlefshmërisë së saj, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 556 të K.Pr.Civile që të referon tek ligji material (vendimi nr. 246 datë vendimi 11.03.2019); nenin 253 të K.Pr.Penale për të vlerësuar se ndalimi i personit nën hetim është bërë në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në këtë dispozitë, si dhe nenin 244 të K.Pr.Penale në lidhje me ndalimin e caktimit të një mase sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga ana e prokurorit, referuar kërkesës së organit të akuzës për caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje”, ndaj personit nën hetim (vendimi nr.831, datë 23.10.2019).

Sa i përket dispozitave të ligjit material të zbatueshëm, gjyqtari ka identifikuar, referuar dhe në disa raste ka cituar dispozita të Kodit Civil, Kodit të Punës, Kodit të Familjes, si dhe të

² Vendimi nr. 36, datë 25.04.2019; Vendimi nr. 110, datë 05.02.2019; Vendimi nr. 11, datë 15.01.2019;

ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjet objekt shqyrtimi. Konkretisht, në 7 nga 8 vendimet e analizuara, referohen dispozita të ligjit material, si më poshtë:

- neni 140 i K.Punës për të përcaktuar llojin e kontratës së punës objekt shqyrtimi me apo pa afat, si dhe neni 153 i K.Punës në kuadër të zgjidhjes së çështjes nëse në rastin objekt gjykimi jemi para një zgjidhjeje të bërë nga ana e punëdhënësit në mënyrë të menjëhershme dhe të justifikuar; neni 144 i K. Punës, në funksion të përcaktimit nëse është respektuar apo jo në rastin konkret procedura e zgjidhjes së marrëdhënies së punës me paditësen, edhe pas konkluzionit se zgjidhja e kontratës së punës ka qenë e menjëhershme dhe e justifikuar (*vendimi nr. 679 datë vendimi 09.07.2019*);
- nenet 215 dhe 220 të K.Familjes, në funksion të zgjidhjes së çështjes referuar të drejtave dhe detyrimeve që kanë prindërit ndaj fëmijëve të mitur edhe pas zgjidhjes së martesës (*vendimi nr. 761, datë vendimi 01.10.2019*);
- identifikon dhe citon ligjin e posaçëm, ligjin nr. 10486 datë 26.11.2001 për trajtimin si titull ekzekutiv të faturave të konsumit të energjisë elektrike, e për rrjedhojë citon edhe nenin 609 të K.Pr.Civile në funksion të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm si dhe të drejtës së paditëses debitore për të kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv (*vendimi nr. 110, datë vendimi 05.02.2019*);
- dispozitat ligjore të ligjit të posaçëm nr. 9669 datë 18.12.2006, "*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*", në funksion të arsyetimit ligjor dhe të zgjidhjes përfundimtare të çështjes. Në mënyrë me specifike, gjyqtari ndalet në nenin 2 të ligjit të posaçëm në lidhje me qëllimin dhe funksionin e ligjit për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave dhe lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje; në nenin 3, për të analizuar "dhunën" në kuptim të këtij ligji; në nenin, 15 në funksion të provueshmërisë dhe diskrecionit të gjykatës në lidhje me lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, sipas bindjes së saj të brendshme (*vendimi nr.36 datë vendimi 25.04.2019*);
- dispozitën materiale penale (*neni 130/a/4 i K.Penal*) në funksion të mbajtjes në konsideratë në trajtimin dhe analizimin e kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës së sigurimit të rrezikshmërisë së veprës penale që i atribuohet personit nën hetim (*vendimi nr. 831, datë vendimi 23.10.2019*).

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet e vëzhguara nuk rezulton të jetë evidentuar konflikt i normave procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe për përshkrimin e tyre, duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim, ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore, që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "*Shumë e lartë*", duke u pikëzuar me 25 pikë.

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre, në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se identifikimi i normës procedurale ose materiale, si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve të çështjes, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Në aktet e analizuara, normat ligjore referohen dhe aplikohen mbi faktet e çështjes, duke u shoqëruar me interpretimin e tyre.

Përgjithësisht, në vendimet e vëzhguara normat ligjore referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes. Në disa raste,³ kur është vlerësuar e nevojshme, normat ligjore janë shoqëruar edhe me interpretim teorik të kuptimit të tyre, interpretim i cili është verifikuar më pas në rrethanat konkrete të çështjes, në funksion të konkluzionit të gjyqtarit për zgjidhjen e çështjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Interpretimi i normave juridike të ligjit material është bërë duke identifikuar qëllimin e normës, përcaktimin e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim dispozita konkrete. Konkretisht, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, sa i përket interpretimit të ligjit material, rezulton se gjyqtari:

- (i) Interpreton dispozitat e ligjit të posaçëm nr. 9669 datë 18.12.2006 "*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*", në lidhje me funksionin, qëllimin, elementët e dhunës (*fizike apo edhe psikike, me apo pa veprime të dhunuesit*), si dhe nivelin e provueshmërisë së saj, interpretim që bëhet në përputhje me rrethanat e fakteve të dala si gjatë gjykimit në shkallë të parë, ashtu edhe gjatë ripërsëritjes pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor në Apel, dhe me provat e paraqitura gjatë gjykimit, si p.sh pohimet e palëve, akti i ekspertimit psikologjik, apo edhe pyetja e fëmijës së mitur gjatë gjykimit në Apel.⁴
- (ii) Interpreton ligjin e zbatueshëm (*nenin 610 të K.Pr.Civile*) në funksion të zgjidhjes së çështjes edhe në lidhje me dy kërkimet e tjera të padisë, jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar qëllimin e dispozitës, afatin dhe shkaqet për të cilat ngrihet kjo padi, por duke e përputhur këtë interpretim me faktin dhe provat e administruara për të konkluduar se veprimet e përmbaruesit gjyqësor janë konform dispozitave procedurale dhe rregullave që kanë lidhje me ekzekutimin e detyrueshëm.⁵
- (iii) Interpreton nenin 153 të K.Punës në lidhje me faktin nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet për të zgjidhur marrëdhënien e punës në mënyrë të menjëhershme në rastin konkret, duke arritur në konkluzionin se jemi para një kontrate me afat të pacaktuar dhe faktit se nga ana e palës së paditur nuk rezulton që të jetë respektuar afati i njoftimit të parashikuar në nenin 143 të K.Punës (*mosrespektim ky i bërë mbi vullnetin e vetë punëdhënësit, duke e konsideruar zgjidhjen e marrëdhënies së punës me paditësen për shkaqe të justifikuar*). Këtë interpretim gjyqtari e bën jo vetëm duke iu referuar

³ Vendimi nr.36, datë 25.04.2019; vendimi nr. 246, datë 11.03.2019; vendimi nr. 679 datë, 09.07.2019;

⁴ Vendimi nr.36, datë 25.04.2019;

⁵ Vendimi nr. 246, datë 11.03.2019;

interpretimit teorik të dispozitës, por në përputhje edhe me faktin dhe provat e administruara. Gjyqtari e interpreton nenin 144 të K.Punës jo vetëm teorikisht, por edhe në përputhje me faktet dhe provat, në lidhje me faktin nëse në rastin objekt gjykimi është respektuar procedura e zgjidhjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit.⁶

-Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale:

Gjyqtari në varësi të natyrës së çështjes si dhe qëndrimit të tij për aspekte procedurale të çështjes, ka interpretuar në përputhje me rrethanat e faktit apo ato procedurale dispozita të caktuara të Kodit të Procedurës Civile, duke dhënë kuptimin e tyre referuar qëllimit të dispozitës, dhe më pas duke e aplikuar mbi faktin/rrethanën konkrete mbi të cilin ajo gjen zbatim. Konkretisht, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, sa i përket interpretimit të ligjit procedural, rezultojnë se gjyqtari:

- (i) Interpreton dispozitat procedurale (*nenet 559, 572, 556 të K.Pr.Civile*), për të përcaktuar rregullshmërinë e veprimeve procedurale të kryera nga ana e përmbartës gjyqësor gjatë ekzekutimit të detyrueshëm;⁷
- (ii) Interpreton nenin 510/d të K.Pr.Civile dhe në përputhje me rrethanat e faktit dhe provat, gjyqtari konkludon se edhe pse kontrata e huasë nuk përbën titull ekzekutiv në kuptim të ligjit, nga ana tjetër, deklarata noteriale e njëanshme e lëshuar nga vetë huamarrësja përbën titull ekzekutiv.⁸

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, evidentohet se gjyqtari në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet duke i përmendur ato shprehimisht dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Gjyqtari referon dhe zbaton *parimin e interesit më të lartë të fëmijës* së mitur, që është në rastin konkret mbrojtja e të miturit nga çdo sjellje e kujtdo që e cenon atë fizikisht, moralisht apo psikologjikisht.⁹

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante, në vendimet e analizuara, referuar objektit të mosmarrëveshjes, rezultojnë që gjyqtari në disa raste ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante, në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij. Konkretisht:

- Gjyqtari mbështetet në qëndrimet dhe jurisprudencën e gjykatave më të larta (*vendimi nr. 487 datë 25.11.2015 i Gjykatës së Lartë*), të cilat edhe pse nuk janë vendime që kanë unifikuar praktikën gjyqësore, janë qëndrime që shërbejnë për interpretimin dhe konkluzionin e arritur (vendimi nr.246, datë 11.03.2019);
- Në konkluzionin e arritur se kontrata e huasë nuk përbën titull ekzekutiv, gjyqtari përmend edhe vendimin unifikues nr. 980, datë 29.09.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (vendimi nr. 11, datë 15.01.2019).

⁶ Vendimi nr. 679 datë, 09.07.2019;

⁷ Vendimi nr. 246, datë 11.03.2019;

⁸ Vendimi nr.11, datë 15.01.2019;

⁹ Vendimi nr.36, datë 25.04.2019;

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen, duke identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe vendimet përfundimtare është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces, si dhe për lexuesin. Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Përdor përgjithësisht të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (*përdor gjithmonë shkronjën “ç”, por nga ana tjetër konstatohet një përdorim shumë i rrallë i shkronjës “ë”*). Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdoruara nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve, përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsyetimit të vendimeve, reflekton qartësi dhe thjeshtësi në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, duke i bërë ato të kuptueshme dhe duke mos lënë hapësirë për kuptim të gabuar apo të ndryshëm të mendimit të shprehur.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari ndjek në hartimin e tyre një strukturë të qartë, të qëndrueshme, dhe të mirëorganizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i përmbahet si prezantimit të fakteve, ashtu edhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtari në rastin konkret ka një metodologji të qartë, sipas pjesëve përbërëse të vendimit, ku në mënyrë të posaçme konstatohet se gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë pjesës përshkruese-arsyetuese, duke e ndarë këtë pjesë pothuajse në të gjithë vendimet në tre nënndarje të tjera, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së tij. Konstatohet se vendimi gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në ankim dhe në proces.

Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa nënpjesë (edhe pse jo me tituj të përcaktuar si p.sh rrethanat e faktit, ligji i zbatueshëm, analiza juridike, nga mënyra e pasqyrimin të tyre, në vendim konstatohet lehtë dhe dukshëm kjo nënndarje) në të cilën: (i) gjyqtari fillimisht ndalet në dhënien e një konkluzioni të përgjithshëm në lidhje me qëndrimin e tij ndaj vendimit të shkallës së parë objekt ankimi, duke u ndalur shkurtimisht tek respektimi i dispozitave procedurale, në funksion të procesit të rregullt ligjor, e në vijim, në lidhje me respektimin e ligjit material dhe vlerësimit të provave nga shkalla e parë; (ii) rrethanat e fakteve të çështjes siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, ku konstatohet se gjyqtari i kushton një rol mjaft të rëndësishëm nxjerrjes së faktit të integruar me provat e administruara, si në shkallë të parë, ashtu edhe referuar provave të marra në shqyrtim gjatë gjyqimit në Apel; (iii) vlerësimi i gjyqtarit, ku merr në analizë ligjin e zbatueshëm dhe elementët e tij, në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe në nenin 466 të K.Pr.Civile. Nga ana tjetër, konstatohet se në pjesën e dispozitivit, përgjithësisht gjyqtari parashikon edhe faktin që ndaj këtij vendimi lejohet rekurs, për t'u bërë i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

Bazuar në analizën e mësipërme, rezulton se gjyqtari ndjek një strukturë përgjithësisht të njëjtë në arsyetimin e vendimeve, strukturë e cila i bën vendimet të qarta dhe lehtësisht të lexueshme.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin "Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit" është "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.*

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe vendimeve gjyqësore të analizuar, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj edhe provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit për provueshmërinë e fakteve konkrete.

Gjyqtari zhvillon analizën juridike për çdo pretendim të ngritur në ankim, ku integron analizën e lidhjes shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, ligjit përkatës dhe mënyrën e aplikimit të tij në rrethanat konkrete, për të konkluduar mbi zgjidhjen përkatëse. Kjo analizë e integruar rezulton veçanërisht në disa vendime:

- Gjyqtari analizon në mënyrë shteruese të gjitha shkaqet dhe pretendimet e palëve, duke analizuar për çdo pretendim të palëve dispozitat përkatëse materiale të ligjit të posaçëm (*nr. 9669 datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar*), në përputhje me rrethanat e faktit dhe provat e administruara. Gjyqtari analizon marrëdhënien shkak-pasojë, konkretisht, veprimet apo edhe mosveprimet e palës së paditur dhe cenimin e integritetit moral fizik dhe psikologjik të të miturës (padi tëses), si pasojë e sjelljes së të paditurës, për të konkluduar se paditësja është dëmtuar psikologjikisht dhe si pasojë, nevojitet lëshimi i urdhrit të mbrojtjes. Gjyqtari analizon se jo vetëm veprimet, por edhe mosveprimet e prindit, nëse këto ndikojnë në krijimin e një gjendjeje pasigurie, ankthi e frike tek e mitura, do të ishin të mjaftueshme sipas ligjit, për të diktuar nevojën e një urdhri mbrojtjeje (vendimi nr.36, datë 25.04.2019);
- Gjyqtari arrin në konkluzion duke vlerësuar ndryshe nga shkalla e parë, mbështetur në një analizë ligjore të çdo prove dhe rrethane fakti të dalë gjatë gjykimit, analizë e cila në përputhje me ligjin e zbatueshëm (*dispozitat procedurale që kanë lidhje me ekzekutimin e detyrueshëm në rastin konkret*). Gjyqtari analizon marrëdhënien shkak-pasojë, konkretisht, veprimet apo edhe mosveprimet e palës paditëse në moskundërshtimin në kohë të veprimeve procedurale të kryera nga ana e përmbaruesit gjyqësor (*në caktimin e vlerës së kuotave në rastin konkret*), në rënien në dekadencë të këtij kërkimi, apo veprimet e palës paditëse në kundërshtimin e veprimeve procedurale për shkaqe që nuk çojnë në pavlefshmëri apo parregullsi të veprimeve procedurale të përmbaruesit gjyqësor gjatë ekzekutimit, etj. (vendimi nr.246, datë 11.03.2019);
- Gjyqtari, gjatë interpretimit të kushteve dhe kriterëve që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative në respektim të nenit 153 të K.Punës, në përputhje me faktin dhe provat, analizon nëse kjo zgjidhje është bërë konform këtyre kriterëve, e në konkluzion të kësaj analize, vlerëson se zgjidhja e kontratës së punës me paditësen është bërë në mënyrë të menjëhershme dhe të justifikuar. Gjatë kësaj analize, gjyqtari përcakton lidhjen shkak-pasojë, e cila konsiston në detyrimet kontraktuale të shkelura nga ana e punëmarrësit, e për rrjedhojë, humbja e besimit në një masë të tillë, nuk e lejon punëdhënësin të vazhdojë marrëdhënien me punëmarrësin (*analiza e nenit 153 të K.Punës* (vendimi nr.679, datë 09.07.2019).

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në treguesin "Cilësia e analizës dhe argumentit logjik". Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse që përbëjnë shkaqe ankimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 121 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë”, kategorisë “Familjare me palë kundërshtarë” dhe kategorisë “Kërkesa penale në fazën e hetimit”.

Duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se:

(i) 17 (shtatëmbëdhjetë) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë”, me objekt “Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv”, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (60 ditë), të parashikuar në nenin 609¹⁰ të K.Pr.Civile. Referuar të dhënave të pasqyruara në tabelat statistikore, evidentohet se 12 (dymbëdhjetë) nga këto çështje janë regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë në muajt nëntor 2016, dhjetor 2016, shkurt 2017, mars 2017, prill 2017 dhe qershor 2017. Afati ligjor 60 ditë për përfundimin e tyre është parashikuar për herë të parë me ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 114/2016, ligj ky i cili është miratuar në datën 03.11.2016 dhe ka hyrë në fuqi në datë 30.11.2016, pra 15 ditë pasi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 219, datë

¹⁰ Neni 609 i K.Pr.Civile “...Kundër vendimit përfundimtar të gjykatës mund të bëhet ankim, sipas rregullave të ankimit të përgjithshëm. Gjykata e apelit e shqyrtton ankimin, brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të tij në këtë gjykatë”.

15.11.2016. Në lidhje me këto 12 çështje pavarësisht faktit se në kohën e regjistrimit të tyre në Gjykatën e Apelit (nëntor 2016, dhjetor 2016, shkurt-qershor 2017), ky ligj kishte hyrë në fuqi dhe pavarësisht rregullit të ligjit procedural në kohën e gjykimit, afati 60 ditë për përfundimin e tyre nuk duhet të llogaritet si afat për gjykimin e çështjes në Apel, por duhet të konsiderohen si çështje me afat standard minimal kohor, pasi ligji i ri nr. 114/2016 që ka sjellë këtë ndryshim nuk ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadive përkatëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, e për rrjedhojë, nuk duhet të jetë as ligji procedural në gjykimin në Apel. Ky interpretim është edhe në frymën e legjislatorit të parashikuar në nenin 109 të ligjit 38/2017, pavarësisht faktit që vetë ligji nr.114/2016 nuk parashikonte ndonjë dispozitë kalimtare në lidhje me zbatueshmërinë e tyre.

(ii) 25 (njëzet e pesë) çështje tek kategoria e çështjeve “*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, të gjitha çështjet me objekt kundërshtim veprimesh përmbarimore për të cilat parashikohet një afat ligjor prej 30 apo 45 ditësh për përfundimin e tyre, sipas paragrafëve 6 dhe 7 të nenit 610 të K.Pr.Civile,¹¹ janë gjykuar jashtë këtij afati, nëse referimi bëhet ndaj datës së regjistrimit të çështjes. Konstatohet se 1 (një)¹² nga këto çështje i është caktuar gjyqtarit me short pas 55 ditësh nga regjistrimi i çështjes në gjykatë. Nëse kësaj çështjeje nuk do t’i llogaritet koha e cila nuk është përgjegjësi e gjyqtarit, rezulton se shqyrtimi i çështjes ka përfunduar pas 44 ditësh, pra brenda afatit ligjor.

(iii) 5 (pesë) nga 6 (gjashtë) çështje të kategorisë “*Familjare me palë kundërshtare*”, me objekt urdhër mbrojtje, për të cilat nenit 21/2 i ligjit nr. 47/2018, parashikon përfundimin e tyre brenda 15 ditësh nga momenti i regjistrimit të çështjes (ankimit), kanë përfunduar jashtë këtij afati ligjor.

(iv) 1 (një) çështje nga 71 (shtatëdhjetë e një) të kategorisë “*Kërkesa në fazën e hetimeve paraprake*”, më konkretisht çështja me nr. rendor 1, ka përfunduar tej afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 291/5 të K.Pr.Penale.¹³

Bazuar në analizën e mësipërme, duke hequr 12 (dymbëdhjetë) çështjet tek kategoria “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, me objekt “*Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv*” dhe 1 (një) çështje tek kategoria “*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor, me numrin total të çështjeve të gjykuara (109 çështje), për të cilat ligji parashikon afat ligjor, është 35 (tridhjetë e pesë)¹⁴, duke rezultuar se gjyqtari ka gjykuar 32% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Referuar ngarkesës së gjyqtarit si relator dhe anëtar (në total ka gjykuar 239 çështje si relator dhe 399 çështje si anëtar), numrit të lartë të

¹¹ Neni 610 i K.Pr.Civile “Shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, si rregull, bëhet nga gjykata e apelit pa praninë e palëve, brenda 30 ditëve. Përgjithësisht, gjykata e apelit mund të vendosë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve brenda 45 ditëve”.

¹² Tabela nr. 1, çështja me numër rendor 14, është regjistruar në datën 24.10.2018 dhe gjyqtari i është caktuar me short në datën 18.12.2018.

¹³ Neni 291 i K.Pr.Penale “5. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve. Gjykata e apelit vendos brenda 30 ditëve nga marrja e akteve”.

¹⁴ Duke zbritur 12 çështjet tek tabela nr. 1 dhe 1 çështje tek tabela nr. 2 nga çështjet me afat ligjor si me sipër arsyetuar.

çështjeve me afat ligjor të shqyrtuara nga gjyqtari, caktimin e gjyqtarit për të gjykuar në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin, mendimit të kryetarit dhe vetëvlerësimit të gjyqtarit, për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet në nivel më të lartë pikëzimi se përqindja e shqyrtuar jashtë afatit ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor, si dhe shkaqet që kanë ndikuar në këtë tregues, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “11-20%”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, me përjashtim të:

(i) 4 (katër) çështjeve tek tabela nr. 1 e kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, konkretisht, çështjet me nr. 46, nr. 48, nr. 49 dhe nr. 52 rendor, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar nga vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD-së, duke u llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

(ii) 1 (një) çështjeje tek tabela nr. 14 e kategorisë “Juridiksion fillestar”, me nr. 9 rendor, e cila ka përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar nga vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD-së duke u llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (5 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (130¹⁵ çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 3.8 % të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “0-10 %”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për të gjitha kategoritë e çështjeve.

¹⁵ Duke shtuar këtu edhe 12 çështjet të cilat u konsideruan si çështje me afat standard minimal kohor, pasi ligji i ri nr. 114/2016 që ka sjellë këtë ndryshim nuk ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesë padive përkatëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, e për pasojë nuk duhet të jetë as ligji procedural në gjykimin në Apel.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” është 63.1 ditë (më e shkurtër se standardi minimal kohor në fuqi); për kategorinë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare” është 38.3 ditë (më e shkurtër se standardi minimal kohor); për kategorinë “Familjare me palë kundërshtare” është 65.1 ditë (më e shkurtër se standardi minimal kohor); për kategorinë “Marrëdhënie pune” është 24.4 ditë (më e shkurtër se standardi minimal kohor) dhe për kategorinë “Juridiksion fillestar” është 31.5 ditë (më e shkurtër se standardi minimal kohor).

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (239 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik (437 çështje), është 54.6%.

Në Formuarin e Vlerësimit gjyqtari ka parashtruar se numri i çështjeve të shortuara dhe të pagjykuara nuk ka lidhje me pakësimin e gjykimeve nga ana ime, por me uljen e numrit të gjyqtareve tek të cilët shortohen çështjet. Nga ana tjetër, fakti i mësipërm ka ndikuar edhe në shtyrjen e gjykimeve për plotësime të trupit gjykues, e në raste të caktuara, edhe për rinisjen nga fillimi të shqyrtimit.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, bazuar në analizën e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga treguesit e tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, deri në një pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit viti kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshill.

Bazuar sa më sipër, duke iu referuar edhe të dhënave statistikore të dorëzuara nga gjyqtari, nga ku rezulton se në periudhën e vlerësimit gjyqtari ka shpallur 234 çështje (civile dhe penale) dhe ka gjykuar 248 çështje, si dhe duke pasur parasysh ngarkesën tejet të lartë të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndikuar kjo edhe nga procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, duke sjellë largimin nga detyra të disa prej gjyqtarëve të kësaj gjykate, fakt që ndikoi në mjaft raste në shtyrjen e seancave gjyqësore dhe në disa raste në fillimin nga e para të shqyrtimit të çështjes, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Mbi 93-99%”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Mbi 93-99%”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin ligjor, është si më poshtë:

- Për çështje të kategorisë *“Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”*, koha mesatare e arsytimit është 7.3 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- Për çështje të kategorisë *“Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”*, koha mesatare e arsytimit është 5.4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- Për çështje të kategorisë *“Marrëdhënie pune”*, koha mesatare e arsytimit është 7.5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
- Për çështje të kategorisë *“Kërkesa penale të hetimit paraprak”* me objekt vlerësim arresti dhe caktim mase sigurimi, si dhe zëvendësim mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 14.9 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 10 ditë, i parashikuar nga neni 249/6 i K.Pr.Penale;
- Për çështje të kategorisë *“Kërkesa penale të hetimit paraprak”*, me objekt shuarje mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 7.5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i parashikuar nga neni 261/3 i K.Pr.Penale në lidhje me nenin 249/6 i K.Pr.Penale;
- Për çështje të kategorisë *“Kërkesa penale të hetimit paraprak”*, për të cilat ligji nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 4.3 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm prej 30 ditësh, i parashikuar nga neni 430/1 i K.Pr.Penale;
- Për çështje të kategorisë *“Juridiksion fillestar”*, për të cilat ligji nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 4.4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm prej 30 ditësh, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.

Për sa më sipër, koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar në ligj, është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural, për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është *“Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”*, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe Raportit Analitik, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet të kategorisë *“Civile e përgjithshme me palë kundërshtare”* është 1.9; për çështjet e kategorisë *“Familjare me palë kundërshtare”* është 1.7; për çështjet e kategorisë *“Marrëdhënie pune”* është 1, si dhe për çështjet e kategorisë *“Juridiksion*

*fillestar” është 1.8. Për të gjitha kategoritë e çështjeve (duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse) numri mesatar i seancave gjyqësore është **1.6 seanca gjyqësore**.*

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, evidentohet se përgjithësisht shqyrtimi i çështjeve gjyqësore ka përfunduar brenda 1 (një) seance gjyqësore, me përjashtim të çështjes me nr. 761 vendimi, datë 01.10.2019, ku konstatohet se për përfundimin e kësaj çështjeje janë zhvilluar gjithsej 3 (tre) seanca gjyqësore. Dy seancat e para gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues (*relatori i çështjes ka munguar dhe sipas relativit të bërë në seancë nga anëtarja e trupit gjykues ka munguar për arsye shëndetësore*).

Referuar sa më sipër, për treguesit e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 1.6 seanca, ndërsa gjyqtari ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se përgjithësisht, në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet (*konstatohet se në asnjë rast nuk është nxjerrë vendimi për caktimin e seancës*) për caktimin e seancës së parë duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve në Apel, konform nenit 460 të K.Pr.Civile. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore të mbajtur me regjistrim audio, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile*), kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi. Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtari tregon kujdes për relativimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relativimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, shpalljen e trupit gjykues, deklarimin e hapur të diskutimit, relativimin nga kryetari i trupit gjykues në mënyrë të përmbledhur të dosjes gjyqësore dhe shkaqeve të ngritura në ankim, parashtrimin e pretendimeve nga palët, dhënien fund shqyrtimit gjyqësor dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Përgjithësisht, seancat kanë filluar në kohë, vetëm në dy raste evidentohet të kenë filluar me vonesë (39 minuta dhe 71 minuta), pa u shoqëruar me relativimin e shkakut, por nuk rezulton që seancat të mos jenë zhvilluar për shkak të kësaj vonese.

Gjithashtu, evidentohet se seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio, si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në procesverbalin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari {...} ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civil në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se aktet në dosje janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve gjyqësore është e rregullt dhe dokumentet janë lehtësisht të aksesueshme, duke përmbajtur aktin e shortit, aktet shkresore të paraqitura nga palët, procesverbalet e seancave sipas datave dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen aktet dhe dokumentacioni në dosje është në përputhje me

veprimet procedurale të kryera nga ana e gjyqtarit. Gjithashtu konstatohet se aktet në dosje dhe dokumentacioni përkatës i përket çështjes konkrete, por nga ana tjetër konstatohet se në të gjitha dosjet e përzgjedhura me short mungon vendimi i kalimit të çështjes në seancë gjyqësore. Gjithsesi kjo mungesë nuk ka sjellë asnjë pasojë procedurale në zhvillimin e gjykimit dhe përfundimin e tij, pasi në cilësinë e relatorit gjyqtari ka marrë të gjitha masat për mbikëqyrjen e njoftimit të palëve për seancën e parë gjyqësore nga ana e sekretarisë gjyqësore. Për çdo gjykim, gjyqtari ka verifikuar njoftimet me shpallje, si kur palët kanë qenë prezent, ashtu edhe kur ato nuk janë paraqitur, duke relatuar këtë fakt në seancë gjyqësore. Asnjë veprim apo mosveprim nga ana e tij nuk ka ndikuar në moszhvillimin e seancave gjyqësore efektive.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion, të gjyqtarit. Nuk evidentohen që nga ana e gjyqtarit të ketë shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërmbajtjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, për gjyqtarin {...} nuk është regjistruar asnjë ankesë pranë ILD-së.¹⁶

Nga raporti i ILDKPKI, përcjellë në KLGJ me shkresën nr. 291/25 prot datë 29.09.2020, konkludohet se gjyqtari *nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme, apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse, gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjyqimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe vlerësimi i kryetarit të gjykatës.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

¹⁶ Informacioni është dërguar nga ILD me shkresën nr. 2129/1 Prot., datë 06.10.2020.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit janar-dhjetor 2019, janë paraqitur nga palët 6 (gjashtë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, nga të cilat janë rrëzuar 5 (pesë) prej tyre dhe është pranuar vetëm 1 (një). Nga ana tjetër, rezulton që nga ana e gjyqtarit janë paraqitur 26 (njëzet e gjashtë) kërkesa për heqje dorë nga të cilat 21 (njëzetë e një) janë pranuar dhe 5 (pesë) prej tyre janë rrëzuar. Ndërkohë, në Gjykatën e Apelit Korçë janë paraqitur 3 (tre) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, të cilat janë rrëzuar të treja.

Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër është “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i drejtpërdrejtë, i qartë, transparent, i kuptueshëm, duke respektuar të drejtat e palëve në proces dhe duke treguar kujdes për të

treguar trajtim të barabartë dhe me dinjitet të tyre. Gjithashtu, rezulton komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë.

Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të orientuar debatin gjyqësor apo për të qartësuar kërkimet e palëve, komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe korrekt në lidhje me çështjet për të cilat pyeten palët, ose përfaqësuesit e tyre.

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore, organizimin e punës në gjykatë dhe komunikimin brenda trupave gjyqësore.

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik rezulton se gjyqtari {...} ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues në 1 (një) aktivitet trajnues¹⁷ pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertit, konvertuar në numër ditësh 5 ditë.¹⁸ Kohëzgjatje kjo që është brenda kufijve të parashikuar nga 5 deri në 40 ditë në vit, në periudhën një vjeçare të vlerësimit.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është nga 5-40 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2019), duke e pikëzuar me 20 pikë.

¹⁷ Shkresa me nr. 789/1 Prot., datë 12.10.2020 e Shkollës së Magjistraturës.

¹⁸ Rregullorja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës në pikën 9 të nenin 55 të saj, parashikon : “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë: **1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim**”.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se gjyqtari {...}, përgjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, ka marrë pjesë në 1 (një) aktivitet trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertit, aktivitet i zhvilluar në datat 11 dhe 12 shkurt 2019. Nuk rezultojnë të dhëna të tjera për përfshirjen e tij në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione të tjera.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e ekspertit në një aktivitet trajnues gjatë periudhës së vlerësimit në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton që gjyqtari gjatë vitit 2019 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, apo aktivitete të tjera.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna. Për pasojë, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me zero pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Në këtë pjesë, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja “c” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi bazën e pikëzimit të kryer, pasqyrohet niveli i vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit, si dhe niveli i përgjithshëm i vlerësimit të gjyqtarit.

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	95	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	388	Shkëlqyeshëm

G - PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e tij të vazhdueshëm në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit për përmirësimin e sistemit gjyqësor.